



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 14.12.2015, në orën 21:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Nuk kishte të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Nga Stafi Mbështetës: Koordinator i Komisionit, Visar Krasniqi.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115.
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115.**

Kryesuesja - Në fjalën e saj tha se kemi një pikë të rendit të ditës, shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115. Sa i përket aspektit kushtetues është në rregull. Kemi 4 amendamente dhe e hapi diskutimin nëse ka dikush ndonjë koment rreth këtyre amendamenteve.

Armend Zemaj – Në fjalën e tij tha se në amendamentin nr. 1, pjesën e parë pajtohem, por te fjalët ‘asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet’, te fjala ‘të mbetet’ nuk mundet sepse është emërim i ri, apo pika 5.3 ‘ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim’ kjo më shumë më duket deklarative se sa normë. Pika 5.4 ‘ka interesa ose angazhohet ‘ më mirë do ishte ka interesa ose është i angazhuar në veprimtari’ sepse para se të emërohet duhet t’i plotësojë këto kritere. Po ashtu te pika 6 ‘Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si drejtor, personi duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa dhe punë menaxheriale’ ose duhet të jetë së paku 5 vjet në fushën menaxheriale, përkatësisht në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa sepse puna menaxheriale ka kuptimin e udhëheqësit.

Doruntinë Maloku- Në fjalën e saj tha tek amendamenti nr. 1, pika 5 ‘asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet drejtor, ndërkohë që te pika 6 është për të pasur të drejtën e zgjedhjes, si drejtor’. Tani nuk e dimë a jemi duke folur për zgjedhjen e drejtorit, apo për emërim të drejtorit dhe tha që kjo gjë duhet të sqarohet.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij të sërishme tha se kemi dy lloj drejtorësh. Çdo anëtar i bordit që sot zgjidhet e merr titullin drejtor, por kemi edhe drejtor menaxhues te pika 8, që thotë ‘drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët menaxhues nuk janë anëtarë të Bordit’, e cila nuk vlen për pikën 8.

Agim Aliu- Në fjalën e tij dha sqarim se asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet që do të thotë se nuk mund të bëhet ai që konkurron nëse nuk mund të mbetet ai që është, sepse gjatë ushtrimit të veprimtarisë ai mund të bëjë një vepër penale.

Armend Zemaj- Më tej tha se duhet të riformulohet pika 8, si vijon ‘Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si drejtor, personi duhet të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune menaxheriale në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet dhe financa.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të sërishme tha se nuk e kam të qartë se çfarë kanë dashur të thonë sepse nëse e themi 5 vjet përvojë pune menaxheriale në fushën e administratës, unë e kuptoj, por a kanë dashur të thonë 5 (pesë) vjet përvojë pune edhe nëse s’je menaxher, por ke punuar në administratë, drejtësi, kontabilitet apo financa dhe ka shtuar fjalën ‘punë menaxheriale’ po që se ka qenë udhëheqës diku, që do thotë i ka dy kuptime.

Doruntinë Maloku – Në fjalën e saj të sërishme tha se nëse e ndryshojmë ‘punë menaxheriale’ në fushën e administratës publike ua mohojmë të drejtën atyre që kanë punuar 5 (pesë) vjet në

administratë publike, por s'kanë qenë menaxherë. Mirëpo nuk mund t'ia mohosh të drejtën dikujt të bëhet drejtor vetëm pse s'ka qenë më parë drejtor.

Kryesuesja- Sqaroi se nëse ne duhet të japim koment ose rekomandim më shumë na shkon ne, si komision, që të japim rekomandimin 'se asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet'. Të hiqet fjala 'mbetet' se nuk mund të mbetet nëse ka bërë ndonjë vepër sesa me hy te kushtet në përzgjedhjen e drejtorit, sepse ne nuk jemi Komision Funkcional. Kjo nuk ka të bëjë direkt me fushën tonë. Ata e kanë fushën të veten dhe ata le t'i përcaktojnë kriteret.

Armend Zemaj- Më tej shtoi se nuk e kisha bërë dikë që nuk e ka asnjë ditë përvojë pune për të udhëhequr privatizimin e vendit, sikur mandatin e kaluar që ka qenë asistente e kompjuterëve.

Doruntinë Maloku- Sa i përket pikës 5 tek amendamenti 1, unë pajtohem me z. Aliu i cili tha që 'përzgjedhja e drejtorit nuk mund të bëhet nëse nuk i plotëson ato kriteret dhe gjithashtu nuk mund të mbetet drejtor nëse në ndërkohë mund të bëjë vepër penale'. Prandaj unë po e shoh të arsyeshme që kjo të mbetet kështu.

Nezir Çoçaj- Në fjalën e tij tha se ne duhet t'i shohim bukur mirë se këtu kemi profesorin Muhamed i cili i shtjellon mirë dhe s'mund të kalojnë në seancë. Jam dakord me Armendin që thotë punë menaxheriale në katër fusha në administratë publike, drejtësi, kontabilitet dhe financa. Këtu janë pesë fusha ku punë menaxheriale është edhe mësuesi, drejtori i shkollës që i ka pesë vjet përvojë si drejtor shkolle dhe mund të shkojë në AKP, sepse e kanë menaxhuar shkollën për pesë vjet ose një ndërmarrje. Unë dhe Armendi jemi të pajtimit që të jetë punë menaxheriale për katër fusha të caktuara që shkojnë me AKP, sepse nuk mund të shkojë ndonjë fushë tjetër vetëm pse i ka pesë apo gjashtë vjet përvojë pune.

Armend Zemaj – Më tej citon ligjin e vjetër, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 'Për të pasur të drejtën e zgjedhjes, si drejtor personi duhet të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa, menaxhim të ndërmarrjeve, punë rregullatore ose përvojë tjetër përkatëse'. Ndërkohë që këtu e kanë futur dhe punën menaxheriale ose le të jetë 5 vjet të ketë qenë menaxher diku që të ruhet një farë niveli të përfaqësimit në AKP ose mos e potencojë hiç.

Doruntinë Maloku- Potenco i se meqenëse jemi në kushte jo normale të punës propozoi që ta procedojmë për seancë dhe ta diskutojmë atje në mënyrë që të mos kemi nevojë edhe njëherë për t'u mbledhur Komisioni Funkcional. Dilemat i shprehim për seancë që mos ta mbledhim edhe njëherë komisionin për shkak të një fjalie.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të sërishme tha se edhe unë mendoj ta lemë kështu edhe pse këto mund t'i interpretohet si të duash. 5 (pesë) vjet përvojë punë në fushën e administratës publike i cili ka mundur të jetë edhe menaxher, edhe veç punëtor apo veç asistent. Edhe në drejtësi ka mundur të jetë asistent juridik, shef i zyrës juridike apo udhëheqës dhe punë menaxheriale është plus. Pa i pasur pesë vjet personi nuk mund të shkojë dhe është çështje tjetër se cilat pozita i ka pasur në këto institucione. Unë mendoj të shkoj kështu si është dhe nëse ka kushte mundemi ta diskutojmë dhe në seancë, tha me tej znj. Halimi në fjalën e saj.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij të sërishme tha se ne nuk e di kush do të zgjidhet nga ata 8 vetë se nuk i kam lexuar kriteret, por ta udhëheq privatizimin e vendit dikush me shkollë të

mesme ose që ka punuar diku apo nëse nuk e ka asnjë ditë përvojë pune si udhëheqës, e të jetë drejtor i krejt aseteve të vendit, më duket jo në rregull.

Kryesuesja- Më tej tha se janë kushtet e përgjithshme kur dalin në konkurs këto pozita. Nuk mund të pranohesh pa diplomë universiteti dhe më pas këto janë kushte që i kërkon ky si institucion.

Agim Aliu – Tha t'i shpjegojmë në emër të komisionit dhe të kërkojmë një sqarim direkt nga komisione ose të bëjmë një propozim duke i thënë që ne e kemi pasur një propozim, por nuk kemi dashur ta ngarkojmë se s'jemi Komision FunkSIONal, por kemi menduar se është më mirë kështu.

Agim Ademaj- Në fjalën e tij tha se është më mirë t'i thuash që keni bërë gabim teknik aty është lidhëza 'dhe' të vendosim 'si' punë menaxheriale'.

Kryesuesja tha se ne po kërkojmë të na japin shpjegim dhe ato le të na japin mendimin e tyre.

Meqë nuk kishte më diskutime tjera, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme nuk pati ndonjë gjë për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 21:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi